

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA” FAKULTETI JURIDIK

Niveli: Master

Programi: Financiar

Mentor: Prof.Dr.Bedri PECE

Kandidat: Adem QEHAJA

ABSTRAKT

Një ndër sektorët financiar me rëndësi të veçantë padyshim që është edhe sektori i sigurimeve i cili zënë vend të rëndësishëm në ekonomin e vendit tonë.

Industria e sigurimeve gjithnjë e më shumë është në zhvillim e sipër e cila gjithë argumentohet përmes rritjes enorme të primeve të sigurimeve. Në kuadër të sigurimeve dominon sigurimi i detyrueshëm i mjeteve motorike, por ajo çfarë vërehet është fakti se edhe sigurimet vullnetare janë në rritje e sipër gjithë që me së miri pasqyrohet duke analizuar anën financiare përkatësisht raportet vjetore të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) të cilat e argumentojnë më së miri këtë pohim.

Kur është fjala për Banken Qendrore të Kosovës është me rëndësi të theksohet fakti se e njëjta ka rëndësi të veçantë në raport me sektorin financiar sidomos kur bëhet fjalë për sektorin e sigurimeve sepse është detyrë primare e BQK-së jo vetëm dhënia e licencës siguruesve, por edhe mbikëqyrja që ju bëhet të njëjtëve përmes inspektimeve të rregullta dhe atyre “ad hoc” me qëllimin e vetëm që në çdo kohë policmabajtësit të ndihen të mbrojtur.

Në përgjithësi kur është fjala për sigurimet duhet theksuar se të njëjtat mund të vështrohen në aspekte të ndryshme, por ne në këtë punim do të kufizohemi në trajtimin e industrisë së sigurimeve në aspektin juridik dhe financiar.

Duke pasur parasysh numrin gjithnjë e më të madh të mjeteve motorike në rrugët tona, kjo ka bërë që të ketë edhe rritje enorme të dëmeve të shkaktuara si pasojë e përdorimit të tyre në komunikacionin rrugor gjithë që për trajtimin e tyre është e nevojshme krahas caktimit të bazës juridike të gjykohet edhe një shumë e caktuar e të hollave që padyshim ka efekte financiare si për siguruesin, të siguruarin dhe palën e tretë të dëmtuar.

Fjalë kyçe: Sigurimet, financat, primi i sigurimit, polica e sigurimit, dëmi.